REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KËSHILLI

VENDIM

Nr.55.date 14/10/2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL NË BASHKINË POLIÇAN TETOR 2024-TETOR 2027

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ,Vendimit të këshillit të ministrave nr.111 datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionim,in e fondit Social". Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.224,datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve përfinancimin e shërbimeve të kujdesit Shoqëror" ,VKM me nr .518 datë .04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit hoqëror komunitar e rezidencial ,kriteret,procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

VENDOSI :

1. Të miratoj Planin Social 3-vjeçar Tetor 202-Tetor 2027 në bashkinë Ploçan sipas materialit bashkëlidhur projekt vendimit.
2. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet drejtoria e Financës dhe Sektori i Shërbimit Social.
3. Ky project vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore"

Vendimi u miratua me 15 vota pro –vota abstenim –vota kunder.

Nr.2426/1 Prot

Date 16/10/2024

Kryetari i Këshillit
Mimoza LULAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POLIÇAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT BERAT

SEKTORI JURIDIK

Nr. 742/19 Prot.

Datë 12 /10/2024

Lënda: Për verifikim të ligjshmërisë së akteve

BASHKIA POLIÇAN

Në mbështetje të ligjit nr 36/2024"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin Qarkut"neni16, pasi verifikova bazueshmërine ligjore të akteve shprehem:

- Konfirmoj Vendimin nr.53,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi i kushtezuar dhe kompesimin e energjise lektr5ike per muajin Shtator 2024"
- Konfirmoj Vendimin nr.54 ,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi i bashkise per muajin Shtator 2024 "
- Konfirmoj Vendimin nr.55,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per miratimin e planit socila ne Bashkine Polican"
- Konfirmoj Vendimin nr.56,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per nje ndryshim ne VKB nr 40 date 22.12.2023"Miratimi i i numrit te pergjithshem te punonjesve te Bashkise Polican Njesive Administrative dhe institucioneve ne varesi te Bashkise per vitin 2024"
- Konfirmoj Vendimin nr.57,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per nje ndryshim ne VKB nr 50 date 12.09.2024"Mbi miratimin e nivelit te pagave te punonjesve te Bashkise Polican Njesive Administrative dhe institucioneve ne varesi te Bashkise per vitin 2024"
- Konfirmoj Vendiminnr.58,datë 14.10.2024 të Këshillit të Bashkise Polican me objekt: "Per miratimin e listes se siperfaqes pyjore/kullosore mbi mundesine e dhenies se tyre per shfrytezin/perdorim"

e marrevshjes se bashkepunimit me Agjencine Shteterore te [illegible]

leje brenda territorit te bashkise ne zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi"p

menaxhimin eprocesit ne Bashkine Polican "

PREFEKTI I QARKUT

Valbona Zylyftari

Adresa : Lagja "28 Nentori"

email: prefekti.berat@mb.gov.al

Tel/Fax: 032 2 34141

PLANI SOCIAL
BASHKIA POLIÇAN
(rishikimi)
TETOR 2024 -TETOR 2027

Contents

HYRJE 3

1. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE 4

1.1 Vizioni 4
1.2 Misioni 4
1.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese 4

2. ANALIZA E SITUATËS 5

2. 1 Kuadri Strategjik 5
2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime 6
2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale 18
2.4 Mangësitë në shërbime 19
2.5 Analiza e Burimeve Njerëzore 22
2.6 Analiza SWOT 23

3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT 24

IV. PLANI I VEPRIMIT 25

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI 1

VI. ANEKSI 1 - TABELAT 2

6 ANEKSE 2

Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike "Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Kavajës, zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

HYRJE

Bashkia Poliçan shtrihet në pjesën jugore të Republikës së Shqipërisë, pjesë e qarkut të Beratit, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 281.15 km². Ajo përbëhet nga tre njësi administrative: Poliçan, Tërpan dhe Vërtop. Ky territor karakterizohet nga një ndërthurje harmonike e vlerave natyrore dhe trashëgimisë materiale-shpirtërore të popullsisë, me peizazhe të larmishme, kurorën e Malit të Bekuar të Tomorrit dhe legjendat e tij mistike, format e veçanta të relievit, klimën e shëndetshme, ajrin e pastër malor dhe një botë të larmishme bimore. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Poliçanit.

Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia Poliçan numëronte 10,953 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil për vitin 2023, popullsia është rritur në 15,932 banorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 26 fshatra, me një densitet prej 56.67 banorë/km².

Rishikimi i Planit Social Vendor 2023-2025 u hartua nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki, nën asistencën e ekspertëve të GOPAS-s. Rishikimi i Planit u parapriu nga:

- ✓ Vlerësimi i zbatimit të masave për periudhën 2023-2024 në PLAN-in 2023-2025.
- ✓ Vlerësimi i nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror për Bashkinë Poliçan.
- ✓ Identifikimi i grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, duke përfshirë madhësinë e grupeve, shtrirjen e tyre në territor, dhe shërbimet ekzistuese që adresojnë nevojat e tyre.
- ✓ Vlerësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Specialistë të departamenteve të ndryshme të Bashkisë Poliçan (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, administratorët shoqëror në njësitë administrative, sektori i Financave, Strehimit, Arsimit dhe Sektori i Burimeve Njerëzore) të mbështetur nga ekspertët e GOPA-s përdorën një kombinim teknikash për identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror. U rivlerësua legjislacioni kombëtar, u konsultuan plane strategjike lokale, dhe praktikat e përditshme të punës që ndiqen në Bashkinë Poliçan. Gjithashtu, u analizuan raporte studimore kombëtare dhe lokale, dhe u mblodhën të dhëna statistikore dhe jo statistikore nga institucione kombëtare dhe lokale.

Raporti dhe gjetjet e tij fillestare u konsultuan në një tryezë me pjesëmarrjen e specialistëve dhe drejtuesve ekzekutivë dhe politikë të bashkisë. Tryeza synoi saktësimin e të dhënave dhe gjetjeve të Raportit, si dhe identifikimin e prioriteteve për ngritjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Poliçan.

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj, Bashkia Poliçan identifikoi dhe planifikoi përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e saj, pjesë e Planit Social 2023-2025.

Pavarësisht përpjekjeve për mbledhjen e të dhënave sa më të sakta, ka një pranim të përgjithshëm që mund të ekzistojnë grupe të tjera në nevojë për shërbime që nuk u arritën të identifikohen për dy arsye kryesore: mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe dhe mungesa aktuale e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësitë administrative. Kjo kufizon mundësinë për të punuar në mënyrë proaktive dhe për rrjedhojë kufizon saktësinë e të dhënave të mbledhura.

Analiza e fundit e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror tregon një rritje të ndjeshme të numrit të individëve që kërkojnë këto shërbime. Sipas të dhënave, janë të paktën 1653 individë, ose 10.14% e popullsisë së bashkisë, që kanë të nevojshme të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Krahasuar me të dhënat fillestare të planit social 2023-2025, numri i individëve në nevojë është rritur me rreth 12.8% në vitin 2023.

Një kategori që ka pësuar rritjen më të madhe është ajo e të moshuarve. Numri i të moshuarve në nevojë ka pësuar një trefishim, nga 150 të evidentuar në planin ekzistues, në 534 pas dy viteve. Kjo tregon se plani social 2023-2025 ka kushtuar më shumë vëmendje dhe burime për të përmirësuar shërbimet e kujdesit për të moshuarit, duke evidentuar rëndësinë e kujdesit për këtë grup të popullsisë.

Kjo rritje e kërkesës kërkon një përgjigje të shpejtë dhe efektive nga ana e bashkisë për të siguruar që të gjithë individët në nevojë të marrin shërbimet e duhura dhe cilësore. Plani social 2023-2025 duhet të rishikohet dhe të përditësohet për të reflektuar këto ndryshime dhe për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të popullsisë.

1. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.1 Vizioni
Sigurimi i mundësisë së përdorimit të shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Poliçan.

1.2 Misioni
Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Poliçan do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në të gjithë territorin e saj (në nivel njësie administrative) në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar cilësinë e jetës së fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

1.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese
1.3.1.Vlerat

- ✓ Plani Social i Bashkisë Poliçan përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- ✓ Ngritjen e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Krijimin e Fondit Social dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij me efektivitet;
- ✓ Përmirësimin e legjislacionit të shërbimeve sociale duke synuar sigurimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të individëve dhe grupeve në nevojë.
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

1.3.2. Parimet udhëheqëse

Hartimi i Planit Social të Bashkisë Poliçan udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të inetresit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të inetresit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.
- ✓ Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

2. ANALIZA E SITUATËS

2. 1 Kuadri Strategjik

Plani social vendor hartohet në përputhje me:

- ➢ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- ➢ Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- ➢ Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- ➢ Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- ➢ Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- ➢ Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- ➢ Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH);
- ➢ Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- CEDAW

Dokumentet strategjike

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohen tek politikat dhe standartet kombëtare. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 (Strategjia) reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare për një mjedis fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze. Kjo strategji synon zbutjen e varfërisë dhe zgjerimin e shërbimeve sociale të integruara dhe cilësore.

Sipas Strategjisë, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe Ligjit nr.121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar. Ligji 139/2015 përcakton funksionet e Bashkisë në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, dhe krijimin e fondit social për financimin e shërbimeve.

Ligji nr.121/2016 rregullon funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe detyron Bashkitë të ofrojnë dhe administrojnë këto shërbime. Sipas nenit 36 të këtij Ligji, Bashkitë duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë nevojat, të hartojnë planin social vendor, të programojnë buxhetet, dhe të kontraktojnë ofrimin e shërbimeve përmes prokurimit publik. Këto procese mundësohen nga VKM nr. 518, datë 4.9.2018 dhe VKM nr. 111, datë 23.2.2018 për krijimin e Fondit Social.


Për të ngritur sisteme të qëndrueshme të kujdesit shoqëror, Bashkitë duhet të kenë struktura dhe stafe të dedikuara. Ligji 121/2016 përcakton ngritjen e strukturave përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë drejtimin strategjik, planifikimin, financimin, dhe monitorimin e shërbimeve. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ka detyrë të identifikojë raste në nevojë, ti menaxhojë ato, dhe informojë publikun për shërbimet shoqërore që ofrohen në territor.

2.2 Vlerësimi i Nevojave për Shërbime

2.2.1 Të dhëna demografike

Të dhënat demografike janë thelbësore për vlerësimin e nevojave të grupeve në risk dhe për planifikimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Poliçan, siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar. Në vitin 2023, Bashkia Poliçan ka një popullsi prej 15,932 banorësh, duke shënuar një rënie prej 448 banorësh krahasuar me vitin 2021. Kjo rënie nuk është homogjene; Njësia

Administrative Poliçan ka humbur 279 banorë, Vërtop 40, dhe Tërpan 129, duke reflektuar një shpërndarje disproporcionale.



Analiza tregon se 45% e popullsisë ndodhet në Njësinë Administrative Poliçan, 43% në Vërtop, dhe 12% në Tërpan. Faktorë si mungesa e shërbimeve, akse i ulët në mundësi punësimi, terreni malor dhe infrastruktura e dobët kanë ndikuar në shpërnguljen e popullsisë drejt qyteteve më të mëdha si Poliçan, Fier dhe Tiranë. Ky fenomen, përveç rënies së popullsisë, ka sjellë një ulje të numrit të familjeve, nga 5,908 në vitin 2021 në 5,874 në vitin 2023. Megjithatë, Njësia Administrative Vërtop paraqet një rast të veçantë, duke regjistruar një rritje të numrit të familjeve me 43, pavarësisht uljes së numrit të banorëve. Ky ndryshim sugjeron se më shumë individë po formojnë familje të ndara, një tendencë që meriton vëmendje për planifikimin e shërbimeve.

Rënia e popullsisë dhe e numrit të familjeve në Bashkinë Poliçan paraqet sfida të rëndësishme për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve publike. Mungesa e punësimit dhe distanca nga shërbimet janë faktorë që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Kjo situatë kërkon një plan strategjik që adreson problemet socio-ekonomike dhe përmirëson infrastrukturën, me qëllim të mbajtjes dhe tërheqjes së popullsisë.

Në përfundim, analiza e të dhënave demografike ofron një pasqyrë të qartë të sfidave dhe mundësive për Bashkinë Poliçan, duke theksuar rëndësinë e këtyre të dhënave për një planifikim të efektshëm dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

2.2.2 Individë në nevojë për shërbime sipas të dhënave statistikore dhe jostatistikore

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në Bashkinë Poliçan zbulon një rritje të konsiderueshme të numrit të individëve që kërkojnë këto shërbime. Sipas të dhënave statistikore, 1653 individë, ose 10.14% e popullsisë së bashkisë, kanë të nevojshme të paktën një formë të kujdesit shoqëror. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 12.8% krahasuar me të dhënat fillestare të planit social 2023-2025, ku vetëm 9% e popullsisë ishte vlerësuar të ishte në nevojë për shërbime të tilla.
Rritja e numrit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror është një tregues i qartë i presionit që po ushtrohet mbi kapacitetet e bashkisë dhe nevojës për të rishikuar e përmirësuar politikat dhe planet sociale aktuale. Kjo rritje reflekton zhvillimet socio-ekonomike dhe sfidat demografike me të cilat përballet bashkia, duke përfshirë plakjen e popullsisë dhe ndryshimet në strukturën e familjeve.

Një nga kategoritë që ka përjetuar rritjen më të madhe është ajo e të moshuarve. Numri i të moshuarve që kërkojnë shërbime është trefishuar, duke kaluar nga 150 individë të evidentuar në planin ekzistues në 534 të moshuar në vitin 2023. Ky ndryshim tregon se plani social 2023-

2025 ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e nevojave të kësaj kategorie, por gjithashtu vë në pah se kapacitetet aktuale të bashkisë janë të pamjaftueshme për të adresuar këtë rritje të shpejtë

Kjo rritje kërkesash në mënyrë të qartë kërkon një përgjigje më të shpejtë dhe më të mirë-organizuar nga Bashkia Poliçan. Për të siguruar që të gjithë individët në nevojë marrin shërbimet e duhura dhe cilësore, plani social aktual duhet të përditësohet për të reflektuar ndryshimet demografike dhe socio-ekonomike. Ky rishikim duhet të përqendrohet në rritjen e kapaciteteve të shërbimeve për të moshuarit dhe përmirësimin e qasjes për të gjitha grupet e popullsisë në nevojë. Rritja e numrit të individëve në nevojë për shërbime, sidomos në zonat më të izoluara dhe rurale, kërkon zgjerimin e infrastrukturës së kujdesit shoqëror dhe rritjen e stafit dhe burimeve për të përmbushur këto nevoja në rritje.

Në përfundim, është e qartë se plani social 2023-2025 duhet të përshtatet për t'u përballur me këtë realitet të ri, duke marrë masa për të përmbushur jo vetëm nevojat aktuale, por edhe ato të ardhshme të popullsisë.

Tabela Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë


	KATEGORITË	Poliçan	Vërtop	Tërpan	Gjithësej
DHËNA DEMOGRAFIKE	Numër banorë ZGjC	7,137	6,808	1,987	15,932
	Numër familje ZGjC	2,823	2,342	709	5,874
INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME	Individë mbi 18 vjeç në familje me N.E	60	131	59	250
	Të papunë	192	13	42	247
	Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç	101	133	43	277
	Fëmijë në nevojë për mbrojtje				7
	Fëmijë në familje me ndihmë ekonomike	58	176	78	312
	Fëmijë me aftësi të kufizuara	16	4	1	21
	Viktima të dhunës në familje	1			1
	Të moshuar në nevojë për shërbime	302	169	63	534
	Të pastrehë				4
GJITHSEJ					**1,653**
Në përqindje sipas popullsisë/ZGjC					**10.38%**


Burimi: Zyra e Ndihmës Ekonomike, Bashkia Poliçan, 2023

Individë në nevojë sipas skemës së ndihmës ekonomike

Në tre vitet e fundit, numri i familjeve që përfitojnë nga Ndihma Ekonomike në Bashkinë Poliçan ka shfaqur variacione të vogla, duke reflektuar ndikimet e politikave sociale dhe ekonomike. Në vitin 2021, ishin 169 familje përfituese, me një rritje të lehtë në vitin 2022, por me një rënie të përsëritur në vitin 2023. Në vitin 2023, vetëm 3.78% e popullsisë mbështetej nga Ndihma Ekonomike, duke përfshirë 2.88% të familjeve që përfitonin nga kjo skemë. Këto luhatje tregojnë një stabilitet relativ në numrin e përfituesve, pavarësisht ndryshimeve të politikës dhe ekonomisë vendase.

Të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Poliçan janë të klasifikuara si zona rurale. . Shumica e familjeve përfituese janë të përqendruara në Njësinë Administrative Vërtop (52%), e ndjekur nga Poliçan (27%) dhe Tërpan (26%). Kjo shpërndarje sugjeron se zonat rurale, veçanërisht Vërtop, kanë një përqendrim më të lartë të familjeve në nevojë.





Analiza e strukturës së grupmoshave të familjeve përfituese tregon se shumica e përfituesve janë fëmijët e moshës 0-15 vjeç, megjithëse përqindja e tyre ka rënë ndjeshëm nga viti 2021 në vitet 2022 dhe 2023. Në të kundërt, grupmosha 19-65 vjeç, që përbën pjesën më të madhe të popullsisë aktive, ka treguar një rritje të konsiderueshme gjatë këtyre viteve. Pjesa e të moshuarve mbi 65 vjeç që përfitojnë nga Ndihma Ekonomike ka mbetur relativisht e qëndrueshme, duke përbërë një pjesë të vogël të përfituesve.

Një aspekt pozitiv është rritja e përqindjes së familjeve që aplikojnë dhe marrin Ndihmën Ekonomike në vitin 2023, e cila tregon përmirësim në qasjen dhe përfitimin e ndihmës. Rreth 8% e familjeve përfituese përfshijnë individë me aftësi të kufizuara, çka e vështirëson situatën e tyre sociale dhe ekonomike, veçanërisht në tregun e punës.

Përveç familjeve përfituese të Ndihmës Ekonomike, Bashkia Poliçan mbështet edhe kategori të veçanta, si fëmijët me status jetimi (4 fëmijë), viktimat e dhunës (1 rast) dhe fëmijët në shërbim kujdestarie (1 fëmijë). Ndonëse shifrat janë të vogla, ato tregojnë përpjekjet e bashkisë për të mbështetur individët më të prekshëm dhe për të adresuar nevojat e tyre specifike.

Rreth 22 familje në nevojë në muaj mbështetën me ndihmë ekonomikë në CASH nga Fondi 6% Nuri është i njëjtë në 3 vitet e fundit, Mbi 50% e familjeve përfituese nga kjo skemë janë gra kryefamiljare të cilat janë vlerësuar në nevojë por nuk përfitojnë nga skema e NE.

Bashkia Poliçan mbështet me ndihma financiare familjet në nevojë që nuk përfitojnë nga dy skemat e përmendura më sipër, duke përdorur fondet e veta. Numri i familjeve që përfitojnë është variabël, duke lëvizur nga 3 deri në 20 familje në vit. Ndërsa në vitin 2021 përfituan 26 familje për një periudhë katërmujore, në vitin 2023 mbështetja është ofruar gjatë të gjithë vitit. Fondi i vënë në dispozicion nga bashkia në vitin 2023 është trefishuar krahasuar me vitin 2021, me një total prej 347,000 lekë, ndërsa në vitin 2021 fondi ishte 112,000 lekë në vit.


Megjithatë, me gjithë përpjekjet e Bashkisë Poliçan, është e nevojshme të rishikohen politikat sociale për të adresuar nevojat e familjeve, veçanërisht në zonat rurale me përqendrim të lartë të përfituesve. Duhet të përmirësohet qasja në ndihmën ekonomike për të siguruar akses të barabartë për të gjitha familjet në nevojë. Një mbështetje e shtuar është e domosdoshme për kategori të veçanta, duke zgjeruar programet për individët me aftësi të kufizuara, fëmijët me status jetimi dhe viktimat e dhunës. Po ashtu, organizimi i sesioneve informuese do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi skemat e ndihmës dhe mundësitë për integrim.

Në përfundim, Bashkia Poliçan ka bërë përpjekje të dukshme për të mbështetur individët dhe familjet në nevojë, por duhet të vazhdojë të përshtatë dhe përmirësojë politikat e saj për të përballuar më mirë sfidat e pranishme dhe të ardhshme.

Punëkërkuesit

Në Bashkinë Poliçan, aktualisht janë regjistruar 247 persona të papunë që kërkojnë punë. Kjo situatë karakterizohet nga një kompleksitet të lartë, që lidhet me faktorët demografikë, arsimorë dhe socialë. Një aspekt i rëndësishëm është shpërndarja e të papunëve: 76.92% e tyre jetojnë në zonat urbane. Kjo tregon se individët që zotërojnë tokë, siç janë fermerët, nuk përfshihen në kategorinë e të papunëve, duke krijuar një profil urban për këtë grup.
Një shqetësim tjetër është përfaqësimi i lartë i grave dhe vajzave, të cilat përbëjnë 55.46% të të papunëve. Kjo përqindje e lartë sugjeron se gratë përballen me pengesa të veçanta në gjetjen e punës. Prandaj, është e domosdoshme të zhvillohen qasje të personalizuara që do t'i mbështesin ato në procesin e punësimit. Një tjetër aspekt shqetësues është se 25.56% e të papunëve janë anëtarë të familjeve që përfitojnë nga Ndihma Ekonomike. Kjo tregon nevojën për mbështetje të shtuar për këtë grup të ndjeshëm, për të ndihmuar në daljen nga varfëria dhe për të siguruar punë të qëndrueshme.

Për më tepër, analiza tregon se 3.63% e të papunëve përfaqësojnë individë me aftësi të kufizuara, si dhe një përqindje e njëjtë përbëhet nga anëtarë të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Këta individë kanë nevoja specifike që kërkojnë vëmendje të veçantë për të përmirësuar mundësitë e tyre për punësim. Po ashtu, gratë kryefamiljare, të cilat përbëjnë 10.93% të të papunëve, përballen me sfida të mëdha për menaxhimin e përgjegjësive familjare, duke rritur vështirësitë në gjetjen e mundësive për punë.



Analiza demografike e të papunëve tregon se shumica, 65.99%, janë në moshë 40 vjeç e lart. Kjo përbën një sfidë të shtuar për këtë grup në gjetjen e mundësive të reja për punësim, duke e bërë nevojshme një fokus të veçantë në ri-kualifikimin e tyre.

Në aspektin e arsimit, situata është gjithashtu shqetësuese: 69.23% e të papunëve kanë arsim 9-vjeçar, 26.72% kanë arsim të mesëm, dhe vetëm 4.05% kanë arsim të lartë. Kjo sugjeron një mungesë të konsiderueshme të arsimit të lartë dhe profesional mes kësaj kategorie.

Të dhënat nga Zyra Vendore e Punësimit tregojnë se vetëm dy persona nga Njësia Administrative Vërtop ndjekin kurse formimi profesional, një femër e moshës 26-50 vjeç dhe një djalë i moshës 14-18 vjeç. Numri jashtëzakonisht i ulët nënvizon nevojën urgjente për të rritur ofertën e programeve të trajnimit dhe formimit profesional për të përmirësuar aftësitë dhe mundësitë e punësimit.

Për të përmirësuar situatën e punësimit në Bashkinë Poliçan, është thelbësore të ndërmerren veprime të koordinuara që adresojnë faktorët e ndërlidhur me papunësinë. Rritja e mundësive të punësimit për të rinjtë, krijimi i programeve mbështetëse për gratë dhe vajzat, si dhe adresimi i nevojave të veçanta të grupeve të margjinalizuara janë hapa të domosdoshëm. Zhvillimi i programeve të trajnimit profesional është një prioritet i rëndësishëm për të siguruar që individët të kenë aftësitë e nevojshme për të hyrë në tregun e punës.


Në përfundim, përpjekjet për të adresuar papunësinë në Bashkinë Poliçan kërkojnë një qasje të shumëanshme, që integron mbështetje të drejtë për grupe të ndryshme dhe promovon arsimin dhe trajnimet profesionale si mënyra për të krijuar mundësi të reja punësimi për të gjithë individët në nevojë.


Individë me aftësi të kufizuara

Në vitin 2023, në Bashkinë Poliçan numri i përfituesve të pagesës për aftësi të kufizuara (AK) arriti në 496 persona, duke shënuar një rënie të lehtë nga 502 përfitues në vitin 2021. Kjo ulje prej 1.2% gjatë tre viteve është e papërfillshme dhe tregon një stabilitet në numrin e individëve që përfitojnë nga kjo ndihmë. Një aspekt pozitiv është që përqindja e grave dhe vajzave me AK ka mbetur e qëndrueshme, duke përbërë 42-43% të përfituesve.

Përqindja e individëve me aftësi të kufizuara në nivel bashkie është 3.11% e popullsisë, dhe shpërndarja gjeografike e këtyre individëve tregon një përqendrim të lartë në Njësinë Administrative Poliçan, ku 46% e tyre jetojnë. Njësia Administrative Vërtop përfshin 44% të individëve me AK, ndërsa vetëm 10% jetojnë në Terpan. Kjo shpërndarje sugjeron nevojën për

përqendrim të burimeve dhe shërbimeve në këto dy njësi kryesore, duke e pasur parasysh se pjesa më e madhe e popullsisë me AK kërkon mbështetje dhe shërbime të specializuara





Analiza e karakteristikave të individëve me AK tregon se 4.03% e tyre janë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, 13.91% janë të verbër, dhe 41.15% janë të vlerësuar nga komisioni bio-psiko-social. Këto kategori përfitojnë pagesa në cash dhe mbështetje nga skemat jo kontributive për grupet në nevojë. Po ashtu, 38.91% e personave me AK janë invalidë pune, të cilët marrin një pagesë invaliditeti për shkak të dëmtimit në punë dhe ndihmë ekonomike shtesë

Rreth 80 individë me AK përfitojnë ndihmë personale, megjithatë vetëm 0.99% e tyre kanë ndihmës personal të përhershëm (të gjithë persona të verbër), ndërsa 99.01% e tyre përfitojnë ndihmë të herëpashershme. Analiza tregon se 85% e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfitojnë ndihmës personal, ndërsa përqindjet për individët e verbër dhe ata me AK të tjerë janë shumë më të ulëta.

Një shqetësim i madh është fakti që nga totali i personave me AK, 135 janë me probleme të shëndetit mendor dhe 79 kanë probleme fizike. Rreth 8.4% e individëve me AK janë fëmijë, me 10 fëmijë që kanë probleme të shëndetit mendor dhe 8 fëmijë që kanë aftësi të kufizuara fizike. Sipas të dhënave të bashkisë, 21 fëmijë me AK jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe nga të dhënat e ZVA Poliçan, 18 fëmijë ndjekin arsimin parauniversitar.

Megjithatë, vetëm 1.2% e individëve me AK ndjekin arsimin e mesëm ose të lartë, duke përfshirë gjashtë persona. Kjo tregon një dështim të dukshëm në integrimin e tyre në sistemin arsimor. Në vitin 2023, ndjekja e arsimit të mesëm nga individët me AK është dyfishuar krahasuar me vitin 2021, por ndjekja e arsimit të lartë ka mbetur e pandryshuar. Profesionistët e fushës së arsimit e lidhin këtë situatë me nivelin e ulët ekonomik të familjeve të individëve me AK, infrastrukturën e dobët për lehtësimin e arsimit, si dhe rezultatet e ulëta në ciklin mësimor.

Në Bashkinë Poliçan ofrohen dy shërbime shoqërore për individët me aftësi të kufizuara: Qendra Polivalente Rezidenciale për të Moshuar dhe individë me AK, ku janë akomoduar 40 persona mbi 65 vjeç (62% gra), dhe Qendra Sociale Ditore për individë me AK, të moshuar dhe familje në nevojë, që ofron shërbime për 52 persona (34.6% gra dhe vajza), nga të cilët 17 janë individë me AK, që përbëjnë rreth 33% të përfituesve të qendrës.
Megjithatë, vetëm rreth 11.5% e individëve me AK në Bashkinë Poliçan përfitojnë shërbime shoqërore (ditore apo rezidenciale). Të dy qendrat janë publike dhe financohen nga shteti, por shërbimet mbeten të kufizuara dhe infrastruktura është e dobët, duke penguar integrimin e individëve me AK në shoqëri dhe arsim.
Për të përmirësuar situatën e individëve me aftësi të kufizuara është e domosdoshme të rritet mbështetja për shërbime sociale dhe arsimore, të përmirësohet infrastruktura dhe të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e integrimit të këtyre individëve në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe ekonomike, duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve sociale me krijimin e më shumë qendrave që ofrojnë shërbime të specializuara, zhvillimin e politikave që mbështesin ndjekjen e arsimit për individët me aftësi të kufizuara, rritjen e fushatave për ndërgjegjësimin e publikut mbi integrimin e tyre dhe investimin në infrastrukturë të përshtatshme për të lehtësuar lëvizjen dhe aksesin e individëve me aftësi të kufizuara.

Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët

Bashkia Poliçan përballet me një sërë sfidash që prekin fëmijët, veçanërisht ata që janë në rrezik përjashtimi social. Bazuar në të dhënat për vitin 2023, janë evidentuar 340 fëmijë në rrezik në këtë bashki, që përbëjnë 2.1% të popullsisë dhe 13.33% të grupmoshës 0-18 vjeç. Kjo situatë thekson nevojën për një vëmendje të veçantë dhe për zgjidhje efektive.

Kategoritë e fëmijëve në rrezik

1. **Fëmijët me Aftësi të Kufizuar:** Janë 21 fëmijë me aftësi të kufizuar që përballen me sfida të mëdha për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate dhe shërbimeve mbështetëse. Të gjithë këta fëmijë kanë shërbimin mbështetës në shkolla nga mësues mbështetës, por ata shpesh jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke u përballur me shtresa të shumfishta të vështirësive sociale dhe ekonomike.
2. **Fëmijët e familjeve në Ndihmë Ekonomike (NE):** Janë 312 fëmijë që jetojnë në familje përfituese të NE. Këta fëmijë janë veçanërisht të rrezikuar për shkak të varfërisë dhe mungesës së burimeve të nevojshme për zhvillim të shëndetshëm dhe arsimim cilësor. Varësia nga ndihma ekonomike tregon një nevojë të thellë për mbështetje shtesë nga strukturat sociale.
3. **Fëmijët e familjeve me një kryefamiljar:** Këta fëmijë, sidomos ata që kanë nënat si kryefamiljarë, përballen me rreziqe të shtuar për shkak të barrës së dyfishtë që përballojnë nënat. Këto familje shpesh hasin vështirësi financiare dhe kanë akses të kufizuar në shërbime arsimore dhe shëndetësore.

Në qytetin e Poliçanit ekziston një çerdhe e vetme që ofron shërbime për 10 fëmijë të grupmoshës 0-4 vjeç. Numri i fëmijëve në çerdhe ka mbetur konstant për tre vitet e fundit, duke treguar për një kapacitet të kufizuar ose kërkesë të ulët nga familjet. Në vitin 2021, në bashki kishte 10 kopshte me 157 fëmijë, por ky numër ra në 9 kopshte në vitin 2022, dhe numri i fëmijëve ra në 119. Në vitin 2023, numri i kopshteve mbetet i njëjtë, ndërsa numri i fëmijëve ra më tej në 107.

Analiza e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet tregon se në njësinë administrative Tërpan mungojnë kopshtet për fëmijët. Nga 107 fëmijët që frekuentojnë kopshtet, 39% jetojnë në Poliçan dhe 61% jetojnë në njësinë administrative. Gjithashtu, nga këto fëmijë, 12 jetojnë në familje përfituese të NE, 2 fëmijë kanë statusin e jetimit dhe 1 fëmijë është me aftësi të kufizuar.

Në vitin 2023, 609 fëmijë ndjekin arsimin e detyrueshëm në 15 shkolla të bashkisë. Ndërsa numri i shkollave ka mbetur i njëjtë, numri i nxënësve ka rënë me 20% krahasuar me vitin 2021. 200 nga fëmijët që ndjekin arsimin bazë jetojnë në familje përfituese të NE, 2 kanë statusin e jetimit, 1 përfiton shërbimin e kujdesit alternativ, 15 përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe 18 i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.

Mungesa e shkollës së mesme në Tërpan krijon vështirësi për nxënësit që duhet të udhëtojnë larg për arsimim, rrit rrezikun e braktisjes shkollore dhe krijon pabarazi arsimore. Kjo ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik dhe thekson nevojën për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në zonë.

Në Bashkinë Poliçan mungojnë shkollat profesionale ose qendrat e formimit profesional. Vetëm dy persona në nivel bashkie ndjekin kursin e formimit profesional në Berat, njëri prej të cilëve është fëmijë. Kjo tregon për një hendek të madh në arsimimin dhe aftësimin e të rinjve për tregun e punës.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Poliçan është emëruar, por kryen edhe detyra të tjera. Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik duhet të forcohet përmes Grupit Teknik të Menaxhimit të Rasteve. Puna e intensifikuar për evidentimin e fëmijëve në rrezik dhe ata në nevojë është e domosdoshme për të siguruar që të dhënat e mbledhura të shërbejnë si bazë për hartimin e politikave sociale në nivel lokal në mbrojtje të fëmijëve.

Në përfundim, situata e fëmijëve në Bashkinë Poliçan kërkon një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, e cila përfshin rritjen e kapaciteteve të çerdheve dhe kopshteve për të siguruar akses të barabartë për të gjithë fëmijët, veçanërisht në zonat rurale. Po ashtu, është e nevojshme të krijohen shkolla profesionale dhe qendra formimi për të rinjtë, duke i përgatitur ata për tregun e punës. Krijimi i programeve mbështetëse për fëmijët dhe familjet në rrezik, si dhe rritja e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, do të ndihmojnë në adresimin e nevojave specifike të këtij grupi. Këto masa do të kontribuojnë në krijimin e një ambienti më mbështetës dhe të sigurt për fëmijët, duke i ofruar atyre mundësitë e nevojshme për zhvillim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, ndërsa rritja e aksesit në arsimin profesional do t'i ndihmojë ata të përgatiten më mirë për të ardhmen dhe të zvogëlojnë varësinë nga ndihma ekonomike.

Viktima të dhunës në familje

Në Bashkinë Poliçan, trajtimi i çështjeve të dhunës organizohet nga Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje (KVDHF). Ky strukturim ka për qëllim ofrimin e një përgjigjeje të koordinuar dhe efektive ndaj rasteve të dhunës. Ekipi multidisiplinar për trajtimin e rasteve është krijuar, dhe drejtuesit e institucioneve mblidhen periodikisht për të analizuar situatën e dhunës dhe për të diskutuar masat që duhen ndërmarrë për të mbështetur viktimat.
Megjithëse të dhënat për vitet e fundit tregojnë një numër të vogël rastesh të raportuara të dhunës në Bashkinë Poliçan, me vetëm tre raste të menaxhuara në vitin 2023, ky tregues nuk pasqyron domosdoshmërisht një ulje reale të dhunës. Mungesa e denoncimeve mund të jetë një rezultat i faktorëve të ndryshëm, përfshirë mentalitetin e fortë të stigmatizimit, nivelin e ulët arsimor dhe ekonomik, si dhe largësinë nga institucionet si bashkia dhe gjykata.

Për të adresuar këtë situatë, është e domosdoshme të zhvillohen fushata vetëdijesimi që inkurajojnë viktimat të denoncojnë dhunën, duke ofruar informacion mbi të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion. Po ashtu, rritja e besimit në sistemin e drejtësisë dhe përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale janë të rëndësishme për të krijuar një ambient mbështetës për viktimat.
Për më tepër, angazhimi i organizatave joqeveritare (OJQ) në nivel lokal mund të ofrojë mbështetje të rëndësishme dhe të ndihmojë në krijimin e një rrjeti mbështetjeje për viktimat e dhunës. Kjo do të kontribuonte në ndërtimin e një kulture që dënon dhunën dhe mbështet viktimat në përballimin e pasojave.
Në përfundim, edhe pse numri i rasteve të raportuara është i ulët, është thelbësore të trajtohen shkaktarët e kësaj situate dhe të përmirësohen mekanizmat e mbështetjes. Angazhimi i institucioneve, si dhe përfshirja aktive e komunitetit dhe OJQ-ve, janë të domosdoshme për të siguruar një përgjigje të efektshme dhe për të garantuar mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në Bashkinë Poliçan.

Të pastrehë

Në përputhje me të dhënat e grumbulluara për periudhën 2021-2023, ne analizojmë aplikimet dhe përfituesit e bonusit të qerasë në Bashkinë Poliçan. Kjo analizë ofron një pasqyrë të qartë mbi nevojat dhe përfitimet e individëve që kanë aplikuar për këtë shërbim, duke identifikuar grupet më vulnerabël në komunitet.

Gjatë periudhës 2021-2023, Bashkia Poliçan ka regjistruar një numër aplikimesh për bonusin e qerasë që varion nga 4 në 7, duke reflektuar një pirje në rënie në vitet e fundit. Po ashtu, numri i përfituesve ka pësuar një ulje, duke arritur në 4 në vitin 2023. Kjo situatë tregon nevojën për një rritje të ndërgjegjësimit dhe mbështetjeve për këto shërbime, në mënyrë që të ofrohet një ndihmë më e madhe për ata që kanë nevojë.

	Aplikime		Përfitues të bonusit të qerasë							
	Numër total gjatë vitit	Femra në %	Përfitues total gjatë vitit	Nga skema e NE	PAK	Jetim	Gra k/familjare	Viktima të dhunës/ Urdhër mbrojtje	Etni rom/egjiptian	Të tjerë
Viti 2021										
Polican	2	2	3							2
Vertop	3		2	1	2				1	0
Terpan	2		2							2
Total i+ ii	7	2	7	1	2	0	0	0	1	4
Viti 2022										
Polican	2	2	2							2
Vertop	3		3	1	2					0
Terpan	1		1							1
Total i+ ii	6	2	6	1	2	0	0	0	0	3
Viti 2023										

Polican	1	1	1							1
Vertop	2		2	1	1					1
Terpan	1		1							1
Total i+ ii	4	1	4	1	1	0	0	0	0	3

Të dhënat gjithashtu tregojnë se individët që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, si dhe viktimat e dhunës në familje, përbëjnë grupet më të prekura nga këto shërbime. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet komunitetit etnik rom egjiptian, të cilat gjithashtu janë të dukshme në listën e përfituesve, duke nënvizuar nevojën për mbështetje të veçantë për këto grupe.

Në vitin 2021, numri i femrave që aplikuan për bonusin e qerasë ishte më i lartë në përqindje, duke treguar se gratë janë shpesh përfitueset kryesore të këtyre shërbimeve. Kjo tregon qartë nevojën për strategji të fokusuara që ofrojnë mbështetje për gratë dhe grupet e margjinalizuara, të cilat shpesh përballen me sfida të shumta në aksesin e shërbimeve sociale.

Për të përmirësuar situatën e shërbimeve dhe për të rritur numrin e përfituesve të bonusit të qerasë, rekomandohet:


1. Zhvillimi i fushatave për informimin e popullsisë mbi mundësitë përfitimi nga bonusi i qerasë, duke përfshirë grupet më vulnerabël si viktimat e dhunës dhe individët nga komunitetet rome dhe egjiptiane.
2. Rritja e burimeve njerëzore dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve të sektorit social për të ofruar mbështetje më efektive për aplikantët.
3. Ndërmarrja e një sistemi monitorimi për të vlerësuar efektivitetin e programeve dhe për të siguruar që mbështetja e ofruar është e përshtatshme për nevojat e individëve.

Këto rekomandime, të zbatuara në mënyrë sistematike, do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve sociale dhe do të sigurojnë një mbështetje më të qëndrueshme për individët në nevojë në Bashkinë Poliçan.

Të moshuar në nevojë për shërbime

Në Bashkinë Poliçan, rreth 534 të moshuar janë evidentuar si në nevojë për shërbime sociale, ku 53.4% e tyre janë gra. Ky grup përbën 3.4% të popullsisë së përgjithshme dhe 14.36% të grupmoshës 67 vjeç e lart. Shumica e tyre jetojnë në Njësinë Administrative Poliçan (56%), ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në Vërtop (32%) dhe Tërpan (12%). Vetëm 170 të moshuar kërkojnë aktualisht shërbime shoqërore, rreth 32% e të moshuarve të evidentuar në nevojë. Shpërndarja e tyre është e ngjashme me shpërndarjen e popullsisë së moshuar në nevojë: 56.47% në Poliçan, 25.88% në Vërtop, dhe 17.65% në Tërpan.

Të dhënat tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e të moshuarve përballen me probleme shëndetësore dhe sociale.



27% vuajnë nga Alzheimeri, 1% përfitojnë Ndihmë Ekonomike, 16% **janë** të vetmuar, 21% janë të braktisur, 18% janë të sëmurë, dhe 17% janë të **varfër.** Këto statistika evidentojnë nevojën e ngutshme për shërbime të specializuara, si dhe për mbështetje të vazhdueshme në kujdesin social.

Megjithëse 534 të moshuar janë identifikuar në nevojë, vetëm 32% e tyre kërkojnë shërbime sociale. Arsyet kryesore për këtë diferencë janë mungesa e ndërgjegjësimit, pamundësia për të lëvizur për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore, dhe barrierat fizike dhe gjeografike si largësia nga qendrat e shërbimeve. Këto sfida janë më të dukshme për të moshuarit që jetojnë në Vërtop dhe Tërpan, ku aksesimi i transportit publik është shumë i kufizuar. Një tjetër pengesë madhore është stigma sociale, që i pengon të moshuarit të kërkojnë ndihmë për shkak të frikës së stigmatizimit, veçanërisht midis grupeve me nivel të ulët arsimor dhe ekonomik.

Në Bashkinë Poliçan aktualisht ofrohen tre shërbime kryesore për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara (PAK):

1. Qendra Polivalente Rezidenciale për të moshuar dhe për PAK, që akomodon 40 persona mbi 65 vjeç (62% gra), duke ofruar strehim dhe shërbime të integruara shëndetësore dhe sociale.
2. Qendra sociale ditore për PAK dhe të moshuar, që ofron shërbime për 11 persona mbi 65 **vjeç** në nevojë për kujdes ditore.
3. Në 1 Tetor 2024 është ngritur një qendër e re dedikuar për rekreacionin e të moshuarve, e quajtur "Kafe dhe rekreacion me të Moshuarin", me një kapacitet deri në 50 të moshuar në dy orare të ndryshme të ditës.

Në total, 19% e të moshuarve të evidentuar në nevojë përfitojnë shërbime shoqërore, që do të thotë se afërsisht 1 në 5 të moshuar në nevojë mbështetet dhe përfiton nga shërbimet shoqërore në Bashkinë Poliçan.

Në kushtet e burimeve të limituara të financimit dhe mungesës së organizatave joqeveritare lokale që mund të ofrojnë mbështetje, sfida kryesore për Bashkinë Poliçan mbetet zgjerimi i shërbimeve sociale për të moshuarit. Bashkia nuk ka një strukturë të veçantë për shërbime të dedikuara për të moshuarit, dhe në rregulloren e institucionit, ndonëse evidentimi i individëve në nevojë është detyrë e përcaktuar për sektorin e shërbimeve sociale, nuk ka një përshkrim të detajuar për këtë proces në pozicionet e punës

Për të adresuar sfidat e shërbimeve për të moshuarit në Bashkinë Poliçan, rekomandohet zgjerimi i ndërgjegjësimit për shërbimet ekzistuese përmes fushatave informuese në terren dhe media lokale, duke përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe takime me të moshuarit dhe familjet e tyre. Përmirësimi i aksesit fizik dhe gjeografik në shërbime mund të arrihet përmes krijimit të rreteve të transportit të dedikuara për zonat rurale si Vërtop dhe Tërpan, si dhe zhvillimit të shërbimeve mobile për ndihmë në shtëpi. Ndërtimi i partneriteteve strategjike me organizata ndërkombëtare dhe vendase do të ndihmojë në sigurimin e financimeve shtesë dhe përmirësimin e kapaciteteve lokale. Për të luftuar stigmatizimin, është thelbësor edukimi dhe informimi publik, si dhe trajnimi i personelit social për të identifikuar më mirë grupet në nevojë. Gjithashtu, ndërtimi i një strukture të qartë brenda sektorit të shërbimeve sociale, me pozicione të specializuara dhe përmirësimin e metodave të evidentimit të individëve në nevojë, është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve për të moshuarit.

Këto ndërhyrje janë thelbësore për të siguruar që të moshuarit në Bashkinë Poliçan të marrin shërbime të denja, të aksesueshme dhe të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

2.3 Vlerësimi i Shërbimeve Aktuale

Kategori prioritare për shërbime të kujdesit shoqëror të evidentuara në Bashkinë Poliçan janë:

- Individët me aftësi të kufizuar, përfshirë fëmijët;
- Familjet e varfëra;
- Fëmijë në nevojë për mbrojtje;
- Gra të vetme, mbajtëse të familjes;
- Gra të dhunuara;
- Të moshuar të vetmuar.
- Familje qe kanë femije me statusin e Jetimit
- Familje me më shumë se 3 fëmijë

Në Bashkinë Poliçan aktualisht ofrojnë shërbime shoqërore vetëm 2 qendra, konkretisht:

1. **Qendra Polivalente Rezidenciale për të Moshuar dhe me Aftësi të Kufizuara** Kjo qendër ofron shërbime rezidenciale për 40 persona mbi 65 vjeç me aftësi të kufizuara, ku 62% janë gra. Qendra është e hapur për të moshuarit jo vetëm nga Bashkia Poliçan, por edhe nga gjithë Shqipëria. Bashkia Poliçan mbulon vetëm 10% të kostove totale, që përbëjnë 2,110,000 lekë në vit, ndërsa 90% mbulohen nga buxheti i shtetit. Përfshirja e të moshuarve nga jashtë bashkisë tregon ndikimin e gjerë të qendrës, por mbulimi i ulët financiar nga bashkia sugjeron nevojën për burime shtesë për të siguruar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe për të rritur kapacitetin akomodues të qendrës.
2. **Qendra Sociale Ditore për PAK, të Moshuar dhe Familje në Nevojë** Kjo qendër sociale ditore, që i shërben të moshuarve, individëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve në vështirësi ekonomike, ofron ndihma ushqimore për 52 qytetarë të moshës 9-70 vjeç. Me rritjen e evidentimit të grupeve vulnerabël, kërkesa për fonde mbështetëse është rritur. E financuar 100% nga bashkia që nga krijimi në vitin 2016, qendra përfitoi financim nga Fondi Social 2023-2025, duke dyfishuar buxhetin nga 1,700,000 lekë në 3,400,000 lekë në vitin 2023. Kjo rritje reflekton përkushtimin e

bashkisë për përmirësimin e shërbimeve dhe zgjerimin e kapacitetit për të ofruar shërbime për rreth 100 individë në nevojë. Bashkia është duke punuar për sigurimin e mjeteve dhe burimeve të nevojshme për zgjerimin e mëtejshëm të këtij shërbimi.

3. Kafe dhe rekreacion me të Moshuarin", dedikuar për rekreacionin e të moshuarve, e quajtur " me një kapacitet deri në 50 të moshuar në dy orare të ndryshme të ditës. Qendra sapo është ngritur dhe mbështetet totalisht nga fondet e bashkisë ,ku si fond investimi ka kostuar 1 920 000 lekë, për vitin 2024.

Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve janë të domosdoshme për të garantuar cilësinë dhe për të adresuar nevojat e përfituesve. Krijimi i një sistemi të integruar të monitorimit për Qendrën Ditore, Qendrën Rezidenciale dhe qendrën "Kafe dhe rekreacion me të Moshuarin", do të lehtësojë identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim dhe për të vlerësuar impaktin e shërbimeve në kohë reale. Një qasje sistematike do të përfshijë mbledhjen e të dhënave, feedback-un nga përfituesit dhe raportimin e rregullt të rezultateve për të mundësuar rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve do të realizohet përmes trajnimeve të rregullta për stafin social, të cilat do të rrisin aftësitë e tyre për të identifikuar dhe ndihmuar më mirë grupet vulnerabël. Gjithashtu, organizimi i takimeve të rregullta me komunitetin dhe përfituesit do të ndihmojë në marrjen e feedback-ut dhe përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes. Krijimi i grupeve mbështetëse për përfituesit do të forcojë rrjetet sociale dhe do të mundësojë ndarjen e përvojave, duke ndihmuar njëri-tjetrin në përballimin e sfidave.

Bashkia Poliçan ka bërë përparime të konsiderueshme në fushën e shërbimeve sociale, veçanërisht me rritjen e financimeve dhe zgjerimin e shërbimeve në dy qendrat ekzistuese. Megjithatë, është e nevojshme të rritet më tej mbulimi financiar, të zgjerohet kapaciteti akomodues, dhe të përmirësohet sistemi i monitorimit për të siguruar që të gjitha kategoritë prioritare të marrin shërbimet e nevojshme dhe me cilësi të lartë. Kjo do të mundësojë një përgjigje më efektive ndaj nevojave në rritje të grupeve vulnerabël në territorin e bashkisë.

2.4 Mangësitë në shërbime

Megjithëse kuadri ligjor dhe shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në ligjin 121/2016 dhe VKM 518/2018, synon mbulimin e nevojave të grupeve vulnerabël, Bashkia Poliçan përballet me një sërë mangësish që kufizojnë efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara. Këto mangësi ndikonin direkt në cilësinë e jetës së qytetarëve më të ndjeshëm, duke përfshirë individët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijët dhe familjet në nevojë.

Tabela 3. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

INDIVIDE NE NEVOJE PER SHERBIME	**BASHKIA Poliçan**	**TIPET E SHERBIMEVE SIPAS SHPORTES**

Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	250	1. ***Program për fuqizimin ekonomik.*** Me prioritet 250 individë të familjeve përfituese të NE. 2.**Krijimi i grupeve** për klasa specifike për hapjen e kurseve të ndryshme ,zanatet e lira sipas kërkesës së individit.
Punëkërkues (247 te rregjistruar – 63 persona te familjene në ndihmë ekonomike)	184	***1. Informimi dhe këshillimi*** për punësim per përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij. Mbajtja në kontakt me sektorin privat për kërkesat e punësimit
Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç (496-21 femije me AK – 196 invalide)	282	***1. Shërbime rehabilituese*** per personat në nevojë për aftësim fizik; 2. ***Shërbimet në familje*** për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe qe e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; ***3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur*** per personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë. **4-Qendra ditore** integruese në shoqëri; 5-**Formim profesional dhe punesim i mbrojtur** per kategorine PAK i lehtë mendor dhe fizik. 6-**Mbështetje në informacion** për ndjekjen e arsimit të mesëm dhe të lartë
Invalidë Pune	196	
Fëmijë në nevojë për mbrojtje	6	***1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,*** shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës ***2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, per*** zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. ***3. Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike***; 4. ***Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;*** ***5. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese*** për fëmijë me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; ***6. Shërbimi i emergjencës 72 orë*** per fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me
Fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike	312	
Fëmijë me aftësi të kufizuara	21	

		aftësi të kufizuara; *7. **Shërbim të specializuara në qendra dhe shtëpi për fëmijët me AK***
Individë viktima dhunë në familje	1	*1. **Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,*** shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje*; 2. **Shërbimi i emergjencës 72 orë,per** v*iktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. 3.**Shërbimi i strehimit të mbrojtur per*** viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë. Organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.
Individë në familje të pastreha	150	*1. **Bonusi i qerasë, 9.***
Të moshuar në nevojë për shërbime	150	*1. **Shërbimet në familje*** për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. *2. **Qendra Sociale ditore*** për të moshuarit, riintegrimi i tyre në shoqëri, krijimi i një ambjenti të ngroht familjar,3.Qendra "Kafe dhe Rekreacion me të Moshuarin" krijimi i një ambjenti çlodhës, argëtues ku të kalojnë kohën e lirë .
Individë në familje që kanë përjetuar divorc	N/A	*1. **Shërbim psikosocial***

Mangësitë e identifikuara:

1. Mungesa e infrastrukturës dhe qendrave ditore. Një nga mangësitë kryesore në Poliçan është mungesa e qendrave të specializuara për persona me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të moshuar. Shërbimet rehabilituese dhe ato ditore janë të kufizuara ose inekzistente, gjë që e bën të vështirë ofrimin e një mbështetjeje të qëndrueshme për këto grupe vulnerabël.

2. Mungesa e personelit të specializuar. Një problem tjetër i rëndësishëm është mungesa e personelit të specializuar për ofrimin e shërbimeve sociale kryesisht shërbimet e specializuara (si logopedist, etj). Stafi ekzistues është i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e shumta për kujdesin social, duke u përballur me një numër të lartë përfituesish për çdo specialist.

3. Mungesa e fondeve dhe burimeve financiare. Financimi për shërbimet sociale është i kufizuar, gjë që ndikon në cilësinë dhe frekuencën e shërbimeve të ofruara. Kjo ka krijuar vështirësi të vazhdueshme në zbatimin e programeve të fuqizimit ekonomik dhe në zhvillimin e kurseve të aftësimit profesional për të papunët dhe individët me aftësi të kufizuara.

4. Mungesa e shërbimeve të personalizuara për grupet vulnerabël. Ndërsa shporta e shërbimeve përfshin një gamë të gjerë shërbimesh, implementimi në nivel lokal është i kufizuar. Për shembull, shërbimet e specializuara për fëmijët në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuara nuk janë të zhvilluara plotësisht, duke mos përmbushur nevojat specifike të këtyre grupeve.

Për të përmirësuar shërbimet sociale në Bashkinë Poliçan dhe për të garantuar një mbështetje më të mirë për individët në nevojë, janë identifikuar disa rekomandime të rëndësishme që fokusohen në zhvillimin e infrastrukturës, rritjen e burimeve njerëzore dhe forcimin e bashkëpunimeve me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare. Këto rekomandime përbëjnë një bazë të qëndrueshme për të adresuar mangësitë ekzistuese dhe për të siguruar një sistem shërbimesh më efektiv dhe të qëndrueshëm:

1. **Zhvillimi i infrastrukturës sociale:** Ndërtimi dhe funksionalizimi i qendrave ditore dhe rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët në nevojë është thelbësor për të siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe cilësore.
2. **Shtimi i burimeve njerëzore:** Rritja e numrit të specialistëve të fushës së shërbimeve sociale, përfshirë psikologë, punonjës socialë dhe specialistë për aftësitë e kufizuara, është një domosdoshmëri për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara.
3. **Rritja e buxhetit për shërbimet sociale:** Nevojitet një rritje e financimit të programeve sociale në mënyrë që të mbulohet spektri i plotë i shërbimeve të parashikuara nga ligji. Kjo do të lehtësonte realizimin e programeve për fuqizimin ekonomik dhe zhvillimin e aftësive profesionale për përfituesit e ndihmës ekonomike.
4. **Ofrimi i shërbimeve të personalizuara:** Është e rëndësishme që shërbimet të përshtaten më mirë për nevojat e individëve, duke përfshirë programe specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës në familje.
5. **Forcimi i bashkëpunimit me sektorin privat dhe OJF-të:** Për të përmirësuar qasjen në shërbime, rekomandohet që Bashkia Poliçan të krijojë partneritete me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të ngjashme ose komplementare.

2.5 Analiza e Burimeve Njerëzore

Bazuar në strukturën e Organikës së Bashkisë Poliçan dhe Rregulloren e saj, Sektori i Shërbimeve Sociale është një segment kritik i departamentit të shërbimeve të Bashkisë, i cili përbëhet nga i) përgjegjësi i sektorit, ii) Specialisti i administrimit të ndihmës ekonomike, PAK, mbrojtjes së fëmijëve dhe shtresave në nevojë, barazisë gjinore, dhunës në familje dhe çështjeve sociale në Bashkinë Poliçan; dhe iii) Specialiste e administrimit të ndihmës ekonomike dhe PAK në Njesitë Administrative Tërpan dhe Vërtop (3 punonjës).

Administratoret shoqërorë në njësitë administrative kanë një varësi të drejtpërdrejtë nga përgjegjësi i sektorit, e cila tregon për koordinimin e veprimtarisë së shërbimeve shoqërore midis bashkisë dhe njësive administrative.

Gjatë analizës së rregullores së institucionit, legjislacionit për shërbimet sociale dhe strukturës së sektorit të shërbimeve sociale, rezulton se në rregullore mungon përshkrimi i detyrave për specialistin që ka përgjegjësi për koordinimin e rasteve të dhunës. Gjithashtu evidentohet se struktura e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave nuk është ngritur ende, as në nivel bashkie as në nivel njësie administrative. Përveç kësaj, stafi i sektorit të shërbimeve sociale ka ndjekur rregullisht trajnimet për menaxhimin e NE, PAK dhe shërbimeve shoqërore. Ndryshimet e reja në legjislacionin për AK ridimensionojnë rolin dhe funksionin e administratorit shoqëror, por këto ndryshime duhet të përditësohen në rregulloren e institucionit për të përmirësuar qasjen dhe efikasitetin e shërbimeve sociale në bashki.

2.6 Analiza SWOT

Fuqi:

- ✓ Kërkesa për shërbime sociale është çështje emergjente sepse shërbimet mungojnë pjesërisht.
- ✓ Domosdoshmëria e sigurimit të shërbimeve sociale për grupet më në nevojë kritike është objektiv i Programit Politik të Kryesisë së Bashkisë.
- ✓ Bashkia Poliçan, ndonëse bashki e re, është e motivuar dhe e paisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.

Dobësi:

- ✓ Mungesa e mbështetjes financiare.
- ✓ Pamjaftueshmëria për mbulim nga Fondit Social.
- ✓ Vlersimi për një vazhdimësi për mbështetjen financiare nga Fondi Social
- ✓ Mungesa e partneriteteve me organizata ndërkombëtare.
- ✓ Prezenca e ulët e organizatave jo fitimrurëse në territorin e Bashkisë.
- ✓ Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- ✓ Pavarësisht decentralizimit, lidhja dhe bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, realizohet nëpërmjet qarkut Berat, jo drejtëpërsëdrejti.

Mundësi:

- ✓ Reforma e Qeverisjes Vendore.
- ✓ Decentralizimi i shërbimi i sociale.
- ✓ Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.

Kufizime

- ✓ Interesi i ulët i organizatave jo fitmprurëse për të punuar në Poliçan.
- ✓ Pesha e lartë specifike e shërbimeve që ofrohen në Berat e shoqëruar me lobimin e fuqishëm nga ana e qarkut Berat.
- ✓ Mungesa e eksperiencës dhe e traditës në Poliçan, vështirëson lidhjen e partneriteteve me organizma të huaja dhe vendase.

3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Përgjithshëm

Qëllimi i këtij plani social është të krijojë një mjedis mbështetës dhe fuqizues për individët dhe familjet në nevojë në Bashkinë Poliçan, duke ofruar shërbime të integruara sociale dhe mbështetje ekonomike që sigurojnë një jetë dinjitoze përgjatë gjithë ciklit të jetës.

Drejtimet dhe Objektivat

Drejtimi 1. Përmirësimi i qasjes në ndihmën ekonomike

Objektivi 1.1: Të analizohet skema aktuale e ndihmës ekonomike për të identifikuar barrierat.

- ✓ Masa 1.1.1: Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit për të mbledhur informacion mbi pengesat.
- ✓ Masa 1.1.2: Hartimi i një raporti mbi rekomandimet për rishikimin e skemave të ndihmës.

Objektivi 1.2: Të krijohen programe mbështetje për kategori të veçanta në nevojë

- ✓ Masa 1.2.1: Zhvillimi i programeve të trajnimeve për individët me aftësi të kufizuara.
- ✓ Masa 1.2.2: Zhvillimi i programeve të trajnimeve për të rinjtë në nevojë
- ✓ Masa 1.2.3: Ofrimi i ndihmës direkte për grate dhe viktimat e dhunës.

Drejtimi 2. Zhvillimi i shërbimeve shoqërore të integruara

Objektivi 2.1: Të krijohen shërbime shoqërore të reja për kategoritë në nevojë

- ✓ Masa 2.1.1: Shërbim transporti për Personat me Aftësi të Kufizuara
- ✓ Masa 2.1.2: Mbështetje psikologjike për fëmijët, rinjtë në rrezik, grate dhe viktimat e dhunës
- ✓ Masa 2.1.3: Shërbimi i kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe personat me Aftësi të Kufizuara
- ✓ Masa 2.1.4: Shërbime shoqërore ditore shumëdisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë

Objektivi 2.2: Të zgjerohen shërbimet shoqërore ekzisturese

- ✓ Masa 2.2.1 Zgjerimi dhe mirefunksionimifunksionimi I shërbimit në Qendrave sociale ditore për PAK, të moshuar dhe familje në nevojë

- ✓ Masa 2.2.2 Rritja e buxhetit të Bashkisë për menaxhimin e rasteve për fëmijët në rrezik
- ✓ Masa 2.2.3 Rritja e buxhetit të Bashkisë për menaxhimin e rasteve të dhunës

Drejtimi 3 Krijimi i mundësive të punësimit

Objektivi 3.1: Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe mundësive stazhi.

- ✓ Masa 3.1.1: Bashkëpunimi me bizneset lokale për krijimin e mundësive të punës.
- ✓ Masa 3.1.2: Organizimi i kurseve trajnimi në aftësi profesionale.

Drejtimi 4. Forcimi i kapaciteteve të stafit të shërbimeve shoqërore

Objektivi 4.1: Organizimi i trajnimeve për stafin lokal.

- ✓ Masa 4.1.1: Zhvillimi i një programi trajnimi për menaxhimin e rasteve.
- ✓ Masa 4.1.2: Trajnime të realizuara për zhvillimin profesional të stafit.

Objektivi 4.2: Të inkurajohen individët që të kërkojnë ndihmë.

- ✓ Masa 4.2.1: Organizimi i aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin mbi shërbimet sociale.

Drjetimi5. Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve

Objektivi 5.1: Të krijohen mekanizma për monitorimin e shërbimeve.

- ✓ Masa 5.1.1: Hartimi i një plani të monitorimit të shërbimeve.
- ✓ Masa 5.1.2: Organizimi i raportimeve të rregullta mbi performancën e shërbimeve.
- ✓ Masa 5.1.3: Zhvillimi i metodologjisë për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve.

Prioritetet e identifikuara

- ❖ Sigurimi i shërbimeve sociale për individët mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike dhe të papunëve.
- ❖ Zhvillimi i shërbimeve ditore dhe mbështetje në familje për të moshuar dhe PAK për të siguruar një mbështetje më të plotë dhe për t'i ndihmuar ata të ruajnë dinjitetin dhe pavarësinë.
- ❖ Zgjerimi i shërbimeve shoqërore ekzistuese
- ❖ Ofrimi i qendrave ditore për individë me nevojë, si dhe shërbime rehabilituese për ata me aftësi të kufizuara.
- ❖ Ofrimi i shërbimeve multifunksionale lëvizëse për të siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë në komunitet për individë që kanë nevojë për ndihmë, duke përfshirë vizita shtëpiake dhe aktivitete edukative.
- ❖ Ofrohen shërbime emergjente për gratë në nevojë, viktimat e dhunës dhe individë në nevojë emergjente
- ❖ Zhvillimi i qendrave multifunksionale për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike.

Burimet e Nevojshme

Për të realizuar me sukses masat e propozuara në kuadër të planit social, është thelbësore të identifikohen dhe sigurohen burimet e nevojshme që do të mbështesin implementimin e aktiviteteve. Këto burime përfshijnë:

1. **Burimet Financiare**: Identifikimi dhe sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për realizimin e masave, duke përfshirë mundësitë për mbështetje nga donatorë të jashtëm dhe bashkëpunimin me sektorin privat. Këto financime janë të domosdoshme për financimin e shërbimeve dhe aktiviteteve.
2. **Burimet Njerëzore**: Përcaktimi i nevojave për stafin, duke angazhuar profesionistë të trajnuar dhe vullnetarë për të garantuar ofrimin cilësor të shërbimeve sociale. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që shërbimet të jenë efektive dhe të aksesueshme.
3. **Infrastruktura**: Identifikimi i hapësirave dhe burimeve materiale që do të nevojiten për ngritjen e qendrave multifunksionale dhe ofrimin e shërbimeve ditore dhe rehabilituese. Kjo do të kontribuojë në ofrimin e mbështetjes së plotë dhe efektive për individët dhe familjet në nevojë.

IV. PLANI I VEPRIMIT

~~MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA Polican~~

Qëllimi i Planit Social Vendor për Bashkinë Polican është të krijojë një mjedis mbështetës dhe fuqizues për individët dhe familjet në nevojë në Bashkinë Poliçan, duke ofruar shërbime të integruara sociale dhe mbështetje ekonomike që sigurojnë një jetë dinjitoze përgjatë gjithë ciklit të jetës.

Drejtimi 1. Përmirësimi i qasjes në ndihmën ekonomike

Masat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheques)	Institucion kontribues (nese ka)
1	2	3	4	5	6	7	8
Objektivi 1.1: Të analizohet skema aktuale e ndihmës ekonomike për të identifikuar barrierat.							
Masa 1: Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit për	Aktiviteti 1 Reakizimi I 10 takimeve me perfaqeseues te komunitetit	i) 10 takime te realizuara (4 ne NJA Polican, 4 nw NJA Vertop dhe 2 ne NJA Terpan ii) 150 perfaqesues te komunitetit te kontaktuar	Janar 2025	Korrik 2025	58,520 leke /Bashkia	Admin shoqerore ne NJA & Sektori social	OJF

	të mbledhur informacion mbi pengesat.		prezantojne sfidat per akses ne skemen e NE					
		Aktiviteti 2 Dokumentimi I aktivitetit	10 proces verbale te mbajtura				Admin shoqerore ne NJA & Sektori social	OJF
	~~Masa 2:~~ Hartimi i një raporti mbi rekomandimet për rishikimin e skemave të ndihmës	~~Aktiviteti 1~~ Analiza e Të Dhënave	~~Grumbullimi dhe analiza e të~~ dhënave ekzistuese mbi skemat aktuale të ndihmës ekonomike	Shtator 2025	Shtator 2025	17,556 leke/Bashkia	Admin shoqerore ne NJA & Sektori social	OJF
		A 2 Konsultimi me Palët e Interesit	3 konsultime te realizuara 30 anetare te grupeve te interesit marrin pjese ne konsultime (3 konsultime x 10 pjesmarres)	Tetor 2025	Nentor 2025	17,556 leke/Bashkia	Admin shoqerore ne NJA & Sektori social	OJF
		A 3 Përgatitja e Raportit dhe dergimi I tij prane drejtuesit te departamentit te sherbimeve sociale	Hartimi I nje raporti te detajuar dhe dergimi I tij prane titullareve	Nentor 2025	Dhjetor 2025	29,260 leke /Bashkia	Admin shoqerore ne NJA & Sektori social	OJF

Objektivi 1.2: Të krijohen programe mbështetje për kategori të veçanta në nevojë							
Masa 1.2.1: Zhvillimi i programeve të trajnimeve për individët me aftësi të kufizuara	A 1 Kryerja e një analize për të identifikuar nevojat specifike të individëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Poliçan	Nje dokument i prodhuar prezanton nevojat specifike per trajnime per PAK	2025	2025	100,000.00 lek Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF
	Aktiviteti 2: Zhvillimi i Programeve të Trajnimeve	3 module trajnimit për individët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë aftësi profesionale, teknologjike dhe jetësore.	Janar 2026	Qershor 2026	120,000.00 lek/Donator (I pambluar)	Sektori Social	OJF
	Aktiviteti 3: Organizimi i Sesioneve të Trajnimit	6 trajnime te realizara, 60 persona me AK rrisin kapacitetet e tyre dhe orientohen drejt tregut te punes	Korrik 2026	Dhjetor 2027	600,000.00 lek/Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF
Masa 1.2.2: Zhvillimi i programeve të trajnimeve për të rinjtë në nevojë	A 1 Kryerja e një analize për të identifikuar nevojat specifike për të rinjtë në nevojë në Bashkinë Poliçan	Nje dokument i prodhuar prezanton nevojat specifike per trajnime per të rinjte ne nevoje	2025	2025	100,000.00 lek Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF

		A 2: Zhvillimi i Programeve të Trajnimeve	3 module trajnimit për të rinjte ne nevoje duke përfshirë aftësi profesionale, teknologjike dhe jetësore.	Janar 2026	Qershor 2026	120,000.00 lek/Donator (I pambluar)	Sektori Social	OJF	
		A 3: Organizimi i Sesioneve të Trajnimit	6 trajnime te realizara, 60 të rinj ne nevoje rrisin kapacitetet e tyre dhe orientohen drejt tregut te punes	Korrik 2026	Dhjetor 2027	600,000.00 lek/Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF	
	Masa 1.2.3: Ofrimi i ndihmës direkte për grate dhe viktimat e dhunës.	A 1 Kryerja e një analize për të identifikuar nevojat specifike të grave dhe viktimave te dhunes në Bashkinë Poliçan	Nje dokument i prodhuar prezanton nevojat specifike per trajnime grave dhe viktimave te dhunes	2025	2025	100,000.00 lek Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF	
		A 2: Zhvillimi i Programeve të Trajnimeve	3 module trajnimit për grate dhe viktimat e dhunes, duke përfshirë aftësi profesionale, teknologjike dhe jetësore.	Janar 2026	Qershor 2026	120,000.00 lek/Donator (I pambluar)	Sektori Social	OJF	
		A 3: Organizimi i Sesioneve të Trajnimit	6 trajnime te realizara, 60 gra dhe viktima te dhunes rrisin kapacitetet e tyre dhe orientohen drejt tregut te punes	Korrik 2026	Dhjetor 2027	600,000.00 lek/Donator (I pambuluar)	Sektori Social	OJF	
Total Drejtimi 1						2,582,892			

Drejtimi 2. Zhvillimi i shërbimeve shoqërore të integruara

Masat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
1	2	3	4	5	6	7	8
Objektivi 2.1: Të krijohen shërbime shoqërore të reja për kategoritë nw nevojë							
Masa 2.1.1 Akses I rritur i PAK në shwrbime	A 1 Shërbim transporti për Personat me Aftësi të Kufizuara	Ne dispozicion te PAK bashkia mundeson sherbimin e transportit pa pagese	2025	2026	600,000.00 leke ne vit /Bashkia	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF

					1,600,000.00 lek /Donator (I pambuluar)	Dep finances	OJF
			2026	2027	500,000 lek ne vit Bashkia	Dep finances	OJF
Masa 2.1.2: Mbështetje psikologjike për fëmijët, rinjtë në rrezik, grate dhe viktimat e dhuës	A 1 Linje keshillimi on line per grupet e targetuara	Ofrimi i nje telefoni jeshil pa pagese	2026	2027	20,000 leke ne vit Bashkia	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF
		Rekrutimi I nje psikologeje per ofrimin e sherbimit			1,440,000 lek/vit Bashkia		

	Masa 2.1.3: Shërbimi i kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe Personat me Aftësi të Kufizuara	A1 Ngritja dhe funksionimi I shërbimit të kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe personat me Aftësi të Kufizuara	Rekrutimi I stifit te qendres	2026	2026	26,336 leke Bashkia	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF	
			Trajnimi I stafit te qendres	2026	2026	120,000 leke /Donator I pambuluar		OJF	
						90,000 leke/Donator I pambuluar			

			Eshte ngritur dhe funksionon sherbmi I kujdesit per te moshuar	2026	2027	3,000,000 lek/vit Donator I pambuluar	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve	OJF	
			dhe PAK , 50 te moshuar dhe PAK marrin sherbime ne shtepi				sociale		
	Masa 2.1.4: Shërbime shoqërore ditore shumedisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë	A 1 Ngritja dhe funksionimi qendres ditore shumedisiplonare, 30 femije dhe 30 familje ne nevoje marrin sherbime ne qender	Rekrutimi I stifit te qendres	2026	2026	26,336 leke Bashkia	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF	

			Trajnimi I stafit te qendres	2026	2026	120,000 leke /Donator I pambuluar		OJF	
						90,000 leke/Donator I pambuluar			
			Eshte ngritur dhe funksionon sherbmi I kujdesit per te moshuar dhe PAK , 50 te moshuar dhe PAK marrin sherbime ne shtepi	2026	2027	5,000,000 lek/vit Donator I pambuluar	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF	

Objektivi 2.2: Të zgjerohen shërbimet shoqërore ekzistuese

Masa 2.2.1 Zgjerimi dhe mirefunksionimifunksionimi I shërbimit në Qendrave sociale ditore për PAK, të moshuar dhe familje në nevojë	A 1 Qendta sociale ditore per PAK, te moshuar dhe familje ne nevoje zgjeron sherbimin e saj,	100 te moshuar, PAK dhe familje ne nevoje marrin sherbime ne qender	2026	2027	6,800,000 lek/vit Donator I pambuluar	Dep. Buxhetit, Dep burimeve njerezore, dep I sherbimeve sociale	OJF
	A2 Mbeshtetje e qendres rezidencial per te moshuar me AK	40 persona mbi 65 vjec perfitojn esherbime ne qender			2,100,000.00 leke vit Bashkia	Dep finances dhe sherbimeve sociale	OJF
	A3 Qendra Kafe dhe rekreacion me të Moshuarin" funksionon nomarlisht	50 te moshuar marrin sherbim ne qender	2026	2027	1 440 000leke vit Bashkia	Dep finances dhe sherbimeve sociale	OJF

	Masa 2.2.2 Rritja e buxhetit të Bashkisë për menaxhimin e rasteve për fëmijët në rrezik	A 1 Bashkia planifikon fonde për menaxhimin e rasteve për fëmijët në rrezik	20 femije ne rrezik marrin sherbime	2026	2027	200,000 leke ne vit Bashkia	Dep. Buxhetit, , dep I sherbimeve sociale	OJF
	Masa 2.2.3 Rritja e buxhetit të Bashkisë për menaxhimin e rasteve të dhunës	A 1 Bashkia planifikon fonde për menaxhimin e rasteve për viktimat e dhunes	5 viktima te dhunes marrin sherbime	2026	2027	100,000 leke ne vit Bashkia	Dep. Buxhetit, , dep I sherbimeve sociale	OJF

25 272 670

Drejtimi 3 Krijimi i mundësive të punësimit

Masat	Aktivititeti	Indikatori	Afat zbatimit		Burimi i financimit	Institucioni pergjegjes	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/sektori/ departamenti (udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)
Objektivi 3.1: Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe mundësive stazhi.							
Masa 3.1.1. Bashkëpunimi me bizneset lokale për krijimin e mundësive të punës	A 1 Identifikimi i bizneseve lokale dhe industrive prioritare	Numri I bizneseve te kontaktuara, Numri I bizneseve qe kane pranuar te bashkepunojne	2026	2026	17,556 leke /Bashkia	Sherbimet sociale ne bashki	Biznese dhe OJF
	A2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset	3 marreveshje te nenshkurara	2026	2026	17,556 leke /Bashkia	Drejtoria juridike dhe sherbimet sociale	Biznese dhe OJF

		A 3 Fushtate informimi për stazhet dhe vendet e punës	3 takime informimi per grupmoshen 26-45 (nje ne cdo Njesia Adminsitrative) 60 te	2026	2026	17,556 leke /Bashkia	Sektor Social	OJF
			banore (50%-gra) informohen ne takimet e informmit					
				2026	2026	17,556 leke /Bashkia	Sektor Social	OJF
			3 fushat informimi me banore 18-25 vjec (nje ne cdo Njesia Adminsitrative)					

				2026	2026	5,000.00 leke Bashkia	Sektor Social	
			1000 flet informimi hartohen dhe shperndahen					OJF
	Masa 3.1.2 Organizimi i sesioneve trajnimi në aftësi. profesionale		1 marreveshje e nenshkruar me QFP				Drejtoria juridike dhe sherbimet sociale	
		A 1 Nenshkrimi I marreveshjes me QFP Berat		Janar 2026	Mars 2026	11,704 leke Bashkia		OJF
		A 2 Kurse formimi profesional zhvillohen ne qytetin e Policanit	3 kurse formimi profesional mundesohen nga QFP ne territorin e bashkise Polican 60 te rinj marrin profesione ne keto kurse	2026	2027	87,780 leke Bashkia	Drejtoria e sherbimit social	OJF

Drejtimi 4. Forcimi i kapaciteteve të stafit të shërbimeve shoqërore

Masat	Aktivitetet	Indikatori	Afat zbatimit		Burimi i financimit	Institucioni pergjegjes	
			Afati i fillimit	**Afati i mbarimit**		Drejtoria/ sektori/departamenti (udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)

Objektivi 4.1: Organizimi i trajnimeve për stafin lokal.

	Masa 4.1.1: Zhvillimi i një programi trajnimi për menaxhimin e rasteve	A 1Hartimi i një manuali trajnimi për menaxhimin e rasteve:		2026	2026	240,000.00 leke Donator I pambuluar	Sherbimi Social I Bashkise	OJF
			1 manual trajnimi me 3 module (nje per menaxhimin e femijeve ne risk, nje per menaxhimin e rasteve te dhunes, nje per menaxhimin e individeve ne situate emergjence ne nevoje)					
	Masa 4.1.2: Trajnime të realizuara për zhvillimin profesional të stafit	A 1 Realizimi I 3 trajnimeve	3 trajnime te realizuara	2026	2027	60,000.00 leke Donator I pambuluar	Sherbimi Social I Bashkise	OJF

	Objektivi 4.2: Të inkurajohen individët që të kërkojnë ndihmë							
	Masa 4.2. 1 Organizimi i aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin mbi shërbimet sociale						Sherbimi Social I Bashkise	OJF
		A 1 Realizimi I takimeve informuese ne cdo njesi administrative	6 takimeve informuese (2 ne cdo njesi administrative) te realizuara, 120 banore informohen	2026	2027	70,224 leke Bashkia		
		A 2 Fushatë ndërgjegjësimi në media lokale dhe rrjete sociale	postera dhe video te prodhuara dhe shperndara ne rrjetet sociale	2026	2027	140,0448.00 leke ne vit Bashkia	Eksperti I komunimit dhe Sherbimi Social I Bashkise	OJF
	Drejtimi 4					510,672.00	leke	

Drejtimi5. Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve

Masat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
1	2	3	4	5	6	7	8
Objektivi 5.1: Të krijohen mekanizma për monitorimin e shërbimeve							
Masa 5.1.1: Hartimi i një plani të monitorimit të shërbimeve	A1 Bashkia ne stafin social te saj ka nje specialist monitorimi per sherbimet sociale	Ne rregulloren e bashkise dhe organiken e saj shtohet pozicioni I monitorues it te sherbimeve sociale	2026	2026	17,556 leke Bashkia	Sektori Juridik, Sektori Burimeve Njerezore,Sektori Social	OJF
		Rekrutohet nje punonjes monitorimi	2026	2027	1,080,000.00 leke ne vit Bashkia	Sektori Burimeve njerezore dhe sektori finances	OJF

		Ndertohet cdo vit plani I punes per monitorimin e sherbimeve sociale	2026	2027		Specialisti I monitorimit te sherbimeve		
Masa 5.1.2: Organizimi i raportimeve të rregullta mbi performancën e shërbimeve	A1 Raporte periodike te hartuar mbi performancen e sherbimeve	4 raporte ne vit te hartuara (1 ne cdo tre muaj)	2026	2027		Specialisti I monitorimit te sherbimeve	OJF	
	A 2 Publikimi i raporteve të performancës në faqen zyrtare të bashkisë dhe në media lokale:	4 raporte te publikuara ne vit	2026	2027		Specialisti I monitorimit te sherbimeve	OJF	

	Masa 5.1.3: Zhvillimi i metodologji së për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve	A1 Bashkia ka miratuar nje metodologji per monitorimin e sherbimeve	1 (nje) metodologji e hartuar	2026	2027	200,000.00 lek/Donator I pambuluar	Sektori Social	OJF	
			Metodologjia e hartuar eshte miratuar nga Keshilli Bashkiak	2026	2027	11,704 leke Bashkia	Sektori Social, Sektori juridik	OJF	
	Total Drejtimi 5					1,309,260.00	Leke		

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi i planit të veprimit do të drejtohet nga grupi tematik për shërbimet sociale, pjesë e përgatitjes së strategjisë dhe planit të veprimit, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Treguesit e përcaktuar për monitorimin dhe vlerësimin e Planit të Veprimit do të shërbejnë për realizimin e monitorimit, sipas periudhave të përcaktuara në Plan. Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik dhe analizimin e progresit dhe problemeve në secilën prej politikave prioritare. Raporti I standartizuar do të përmbajë fakte dhe të dhëna të standartizuara, bazuar në kornizën e indikatorëve të parashikuar nga ky plan lokal.

I gjithe procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e perfaqesuesve nga institucionet kryesore kombëtare përgjegjëse për mbrojtjen sociale (përfshi Sherbimi Social Shtetëror), përfaqësues nga qarqet akademike dhe qendrat universitare, shoqëria civile, (përfaqësues të shoqatave të formuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave të grupeve të përjashtuara) etj,

Draftet e raporteve vjetore të monitorimit do të përgatiten në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe do të miratohen nga Këshilli Bashkiak.

Në mbështetje të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit, lidhur me treguesit e ndikimit do të jenë edhe të dhënat administrative të siguruara nga studime lokale mbi përjashtimin social dhe përfshirjen sociale.

VI. ANEKSI 1 - TABELAT

6 ANEKSE

Tabela 1 Të dhëna mbi popullsinë sipas njësive administrative në vite

Njësitë administrative	Popullsia	
	Viti 2021	**Viti 2023**
Poliçan	7,416	**7,137**
Vërtop	6,848	6,808
Tërpan	2,116	1,987
Total	**16,380**	**15,932**

Tabela 2 Struktura e grupmoshave të familjeve

Grupmosha	Popullsia sipas njësive Administrative viti 2023			
	Poliçan	**Vërtop**	**Tërpan**	Total
0-5 vjeç	341	325	95	762
6-15 vjeç	396	378	110	884
16-18 vjeç	408	389	114	911
19-64 vjeç	4,326	4,126	1,204	9,656
65+ vjeç	1,666	1,589	464	3,719
Totali	**7,137**	**6,808**	**1,987**	**15,932**

Tabela 3 Dinamika e familjeve në vite

Njësitë administrative	Numri i familjeve	
	Viti 2021	**Viti 2023**
Poliçan	2882	2823
Vërtop	2294	2342
Tërpan	732	709
Total	5908	5874

Tabela 4 Të dhëna mbi skemën e NE në vite

Përshkrimi	Nëntor 2021		Nëntor 2022		Nëntor 2023	
	Nr.	Fond Lek	Nr.	Fond Lek	Nr.	Fond Lek
Familje përfituese të NE	169	1,665,150	179	1,141,582	163	1,175,575
Individë me status jetimi	5	45,000.00	5	49,500.00	4	39,600.00
Individë viktima të trafikimit						
Individë viktima të dhunës					1	9,000.00
Prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh						
a) trinjakë						
b) Katënjakë						
c) Pesë e më shumë së fëmijë të lindur njëherësh						
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	3	27,000.00	2	18,000.00	1	9,000.00
Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare						
Total		**1,737,150**		**1,209,082**		**1,233,175**

Tabela 5 Të dhëna mbi familjet përfituese të NE për çdo njësi administrative për vitin 2023

Njësitë administrative	**Familje përfituese të NE viti 2023**
Poliçan	37
Vërtop	88
Tërpan	44
Total	**169**

Tabela 6 Të dhëna mbi familjet përfituese të NE viti 2023

Nr familje ne NE	**Nr Familje**	**Nr personave përfitues të NE**
Familje me 1 anëtar	9	9

Familje me 2 anëtar	20	40
Familje me 3 anëtar	31	93
Familje me 4 anëtar	63	252
Familje me 5 anëtar	42	210
Familje me 6 anëtar	4	24
Familje me mbi 6 anëtar	0	0
Total	**169**	**628**

Tabela 7 Grupmosha e përfituesve të NE në vite

Vitet	Anëtarët të familjeve përfituese të NE sipas grupmoshës				Nr familjesh përfituese të NE
	0-15 vjeç	16-18 vjeç	18-67 vjeç	mbi 67 vjeç	
2021	56.2%	7.9%	34.6%	1.3%	177
2022	48.0%	6.9%	43.5%	1.6%	184
2023	48.3%	6.5%	43.9%	1.2%	169

Tabela 8 Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme në nivel Bashkie

	Grup- mosha	Total persona të Papunë Punëkërkues të ndarë sipas							
		Qytet/Fshat		Sipas gjinisë		Sipas statusit			
		Urban	Rural	Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjiptiane	Emig- rantë të kthyer	Gra krye-familjare
16-19 vjeç		5	1	4	2				
20-24 vjeç		9	4	10	3				
25-29 vjeç		4	6	6	4	2			
30-39 vjeç		38	17	38	17	4	5		10
40+		134	29	79	84	3	4		17
Total		190	57	137	110	9	9		27

Tabela 9 Papunësia sipas nivelit arsimor

	Niveli arsimor		Femra	Meshkuj	TOTALI
Pa arsim					
Fillore					
9-vjeçare			95	76	171

E mesme përgjithshme	35	31	66
E mesme profesionale			
Arsimi Universitar	7	3	10
Total	137	110	247

Tabela 10 Të dhëna mbi përfitimin e pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar

Pershkrimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
	Numer mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Numer mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Numer mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor
1. Para dhe tetrap	**21**	**9**	**7,402,295**	**19**	**8**	**8,538,192**	**20**	**9**	**10,883,069**
Polican	*10*	5	3,693,343	9	5	5,174,964	10	6	3,325,841
Vertop	*9*	4	2,995,384	8	3	2,649,660	8	3	2,958,840
Terpan	*2*	-	713,568	2	-	713,568	2		4,598,388
2 Të verbër	**73**	**29**	**12,363,724**	**67**	**27**	**11,783,326**	**69**	**28**	**13,238,221**
Polican	34	12	6,015,066	30	12	5,217,881	31	11	6,278,465
Vertop	35	17	5,656,642	33	15	5,837,429	35	17	6,408,668
Terpan	*4*	-	692,016	4		728,016	3		551,088
3 Invalidë	**206**	**79**	**8,109,800**	**205**	**80**	**7,813,200**	**193**	**73**	**7,437,000**
Polican	113	42	4,434,200	113	43	4,307,000	106	35	4,039,700
Vertop	79	34	3,121,200	79	34	2,991,400	75	35	2,922,100
Terpan	*14*	3	554,400	13	3	514,800	12	3	475,200
4 PAK të tjerë	**202**	**93**	**30,884,399**	**204**	**98**	**30,718,691**	**214**	**99**	**30,099,968**
Polican	80	37	12,043,714	76	38	11,910,180	81	38	10,085,417
Vertop	*89*	38	13,498,057	94	41	13,989,311	100	42	15,416,163
Terpan	*33*	18	5,342,628	34	19	4,819,200	33	19	4,598,388
Total 1+2+3+4	**502**	**210**	**58,760,218**	**495**	**213**	**58,853,409**	**496**	**209**	**61,658,258**

Tabela 11 PAK mendorë dhe fizikë sipas moshës

Tabela 12. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e mesëm

Pershkrimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023

	Nr mesatar personash		Fondi vjetor	Nr mesatar personash	Fondi vjetor	Nr mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike		0	-	-	-	-	
Polican							
Vertop							
Terpan							
2 Të verbër		0	-	-	-	-	
Polican							
Vertop							
Terpan							
3 Invalidë		0	-	-	-	-	
Polican							
Vertop							
Terpan							
4 PAK të tjerë		1	196,644	2	404,560	4.00	415,626
Polican				1	214,470	2.00	151,782
Vertop		1	196,644	1	190,090	2.00	263,844
Terpan							
Total 1+2+3+4		1	196,644	2	404,560	4.00	415,626

Tabela 13. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e lartë

Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Nr mesatar personash	Fondi vjetor	Nr mesatar personash	Fondi vjetor	Nr mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike	0		-		-	
Polican						
Vertop						
Terpan						

2 Të verbër		0	-	1	365,175	1	126,828
Polican		*0*		1	365,175	1	126,828
Vertop							
Terpan							
3 Invalidë		0		-		-	
Polican							
Vertop							
Terpan							
4 PAK të tjerë		3	959,175	2	571,920	1	61,830
Polican		*3*	959,175	2	571,920	-	-
Vertop		0		-		1	61,830
Terpan							
Total 1+2+3+4		**3**	**959,175**	**3**	**937,095**	**2**	**188,658**

Tabela 14 Përfitimi i ndihmësit personal

Përshkrimi		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Numer mesatar PAK përfitues të Ndihmësit Personal		Fondi total vjetor	Numer mesatar PAK përfitues të Ndihmësit Personal	Fondi total vjetor	Numer mesatar PAK përfitues të Ndihmësit Personal	Fondi total vjetor
1. Para dhe tetraplegjike		19	2,722,795	17	3,184,940	17	3,525,138
Polican		*10*	1,445,055	9	3,060,244	9	2,310,354
Vertop		*9*	1,277,740	8	124,696	8	1,214,784
Terpan							
2 Të verbër		12	1,426,219	11	13,408,357	13	1,618,036
Polican		*8*	942,064	7	12,888,764	8	1,041,508
Vertop		*4*	484,155	4	519,593	5	576,528
Terpan							
3 Invalidë		0	-	0	-	0	-
Polican							
Vertop							
Terpan							
4 PAK të tjerë		*50*	*7,613,051*	*44*	*6,060,185*	*48*	*6,462,799*
Polican		*18*	2,767,518	17	2,258,935	19	2,393,885
Vertop		*32*	4,845,533	27	3,801,250	29	4,068,914
Terpan							
Total 1+2+3+4		81	11,762,065	72	22,653,482	78	11,605,973

Tabela 15 Të dhëna për situatën aktuale të fëmijëve në nevojë

Përshkrimi	Total	M	F
Fëmijë në konflikt me ligjin			
Të shfrytëzuar për punë			
Viktima të trafikimit/të mundshme trafikimi			
Jetim	4	2	2
Fëmije 0-15 vjeç në familje me NE	275		
Fëmijë 15 vjeç e lart në familje me NE	37		
Fëmijë me AK	21	10	11
Fëmijë pa kujdes prindëror			
Fëmijë viktima të dhunës	1	1	0

Fëmijë në shërbim kujdesi alternative	1	1	5
Nr. total i fëmijëve në kujdes rezidencial në fund të vitit	0	0	0
Nr. fëmijëve në shtëpinë e foshnjës në fund të vitit	1	0	0
Nr. i fëmijëve me AK në kujdes rezidencial publik (në të gjitha institucionet) në fund të vitit			
Fëmijë në situatë rruge			
Fëmijë që nuk shkojnë në shkollë rregullisht (15-18 vjeç)			
Total	**340**	**14**	**18**

Tabela 16 Të dhëna mbi dhunën

Të dhëna		Polican			Vertop			Terpan		
		Njësia Administrative			Njësia Administrative			Njësia Administrative		
		Viti 2021	Vitit 2022	Vitit 2023	Viti 2021	Vitit 2022	Vitit 2023	Viti 2021	Vitit 2022	Vitit 2023
UMM		2	4	1	1	1	2	1	0	0
UM		0		1			1			
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës										
	Gra	2	4	1			2	1		
	Fëmijë	4		2						
	Të moshuar	0			1	1	1	1		
	Burra	0			1	1				
Karakteristika te viktimave të dhunës mbi 18 vjec										
	Të papunë	1	4	1						
	Përfitues të NE	1					1			
	Të Pastrehë	0								
	Pensioniste	0			1	1	1	1		
	Total Bashkia									

Tabela 17 Strehimi/bonusi i qirasë

Tabela 18 Të dhëna për moshën e tretë

Kategoria	Detajuar	Njesite adminsitrative			Total Bashkia
		Polican	Vertop	Terpan	
1- Të moshuar që kërkojnë shërbime					
	Total	**80**	**40**	**30**	**150**

Të moshuar qe kerkojne sherbim ne familje	F	48	21	18	87
	M	32	19	12	63
Nr I të moshuarve që kërkojnë shërbim ne qender ditore	**Total**	**12**	**1**	**0**	**13**
	F	3	0	0	3
	M	9	1	0	10
Nr I të moshuarve qe kërkojnë shërbim rezidencial	**Total**	**4**	**3**	**0**	**7**
	F	3	0	0	3
	M	1	3	0	4
TOTAL 1		**96**	**44**	**30**	**170**
2-Të moshuar në nevojë					
Nr I të moshuarve që jetojnë vetëm dhe që përfitojnë NE	**Total**	**0**	**2**	**1**	**3**
	F	0	0	1	1
	M	0	2	0	2
Të moshuar të vetmuar	**Total**	**48**	**32**	**15**	**95**
	F	27	19	7	53
	M	21	13	8	42
Të moshuar të sëmurë	**Total**	**80**	**15**	**12**	**107**
	F	48	7	7	62
	M	32	8	5	45
Të moshuar të braktisur	**Total**	**80**	**32**	**12**	**124**
	F	48	19	7	74
	M	32	13	5	50
Të moshuar të varfër	**Total**	**30**	**45**	**27**	**102**
	F	12	24	14	50
	M	18	21	13	52
Të moshuar me A	**Total**	**82**	**64**	**9**	**155**
	F	35	24	3	**62**
	M	47	40	6	**93**
TOTAL 2	**Total**	**302**	**169**	**63**	**534**
	F	**154**	**94**	**37**	**285**
	M	**150**	**97**	**37**	**284**

KRYETARI I BASHKISË
Adriatik ZOTKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLICAN